

Katalogu i publikimeve

Banka e Shqipërisë

2007

p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



PËRMBAJTJA

HYRJE	5
BULETINI EKONOMIK	7
ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË	8
MATERIALE DISKUTIMI	13
BOTIME TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË	16
METODIKA E BILANCIT TË PAGESAVE	16
LIGJI NR. 9662, DATË 18.12.2006 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"	16
BOTIME EDUKATIVE	17
PARAJA ELEKTRONIKE: E ARDHMJA E PARASË?	17
BANKA E SHQIPËRISË – BANKA JONË QENDRORE	17
ABC-JA E NORMAVE TË INTERESIT	18
BANKAT NË EPOKËN E INTERNETIT	18
NDËRTONI TË ARDHMEN – PLANIFIKONI TË ARDHURAT TUAJA	18
GODINA E BANKËS SË SHQIPËRISË	19
REGJISTRI I KREDIVE (FLETËPALOSJE)	19
ÇFARË ËSHTË RAPORTI PËR KREDIMARRËSIN?	19
INFLACIONI I SHËNJESTRUAR 2 – TRYEZË E RRUMBULLAKËT, TIRANË, 7-8 DHJETOR 2006	20
KONFERENCA VII "STRATEGJITË E POLITIKËS MONETARE PËR EKONOMITË E VOGLA", TIRANË, 6-7 DHJETOR 2007	30
PUBLIKIME PERIODIKE	40
RAPORTI VJETOR	40
RAPORTET E POLITIKËS MONETARE	40
RAPORTI STATISTIKOR	41
BULETINI ZYRTAR	41
RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES	41
BULETINI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE	42
ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, TË PUBLIKUAR NË SHTYPIN VENDAS	42



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë

HYRJE

Katalogu i Publikimeve të Bankës së Shqipërisë 2007, është një përmbledhje e kolanave periodike, e raporteve periodike ose jo; dhe e të tjera botimeve që kemi përgatitur për bankat tregtare, për institucione të ndryshme e individë, për publikun e gjerë në përgjithësi, brenda e jashtë vendit, gjatë këtij viti.

Shpërndarja e tyre bëhet falas, sipas një liste e cila përfshin administratën publike, bankat e nivelit të dytë, institucione të ndryshme dhe këdo tjetër që është i interesuar për to.



p u b l i k i m e

të Bankës së Shqipërisë



Banka e Shqipërisë boton një sërë publikimesh të cilat janë me interes për profesionistët si në fushën e biznesit, në atë të bankingut, për akademikët dhe për publikun e thjeshtë. Duke filluar që nga viti 2005. Titujt e tyre janë përmbledhur në një katalog.

BULETINI EKONOMIK

Buletini Ekonomik përmbledh analiza, vlerësime që kanë të bëjnë me politikën monetare të Bankës së Shqipërisë si dhe informacione të ndryshme mbi sistemin bankar. Ky publikim ka një frekuencë tremujore dhe përmban: raportet periodike të politikës monetare, të cilët botohen në zbatim të kërkesave të ligjit në fuqi "Për Bankën e Shqipërisë"; prezencën e administratorëve të Bankës së Shqipërisë në publik; artikuj të ndryshëm që trajtojnë çështje ekonomike, financiare apo juridike; rezultate të vrojtimit të kryera nga Banka e Shqipërisë; listën e bankave të nivelit të dytë që kanë marrë licencë për të operuar në Republikën e Shqipërisë, adresat dhe kontaktet e tyre; strukturën organizative dhe drejtuesit e Bankës së Shqipërisë (anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe drejtorët e departamenteve).



ARTIKUJ TË BOTUAR NË BULETININ EKONOMIK TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Buletini Ekonomik, Vëllimi 10, nr. 1, mars 2007

INFORMACION MBI MODULIN E REZERVËS
NDËRKOMBËTARE DHE LIKUIDITETIT NË VALUTË TË HUAJ.
HILDA SHIJAKU, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave
Financiare, Departamenti i Statistikës.

Materiali jep një informacion mbi kompilimin e modulit të rezervës ndërkombëtare dhe likuiditetit në valutë të huaj si një statistikë e rëndësishme makroekonomike, e detyrueshme për t'u raportuar prej standardeve të Projektit SDDS, në të cilin Shqipëria synon të anëtarësohet në fund të vitit 2007. Ky modul vendos standardet për informimin e publikut mbi madhësinë dhe përbërjen e mjeteve të rezervës, të mbajtura nga autoritetet qendrore: banka qendrore dhe qeveria qendrore; si edhe specifikon mënyrën e raportimit të detyrimeve afatshkurtra në valutë të huaj dhe aktiviteteve të lidhura me to. Kompilimi i kësaj statistike është në përputhje me "Udhëzuesin e Modullit të Rezervës Ndërkombëtare dhe Likuiditetit në Valutë të Huaj, FMN, 2001" dhe kompilohet për herë të parë në Shqipëri.

TENDENÇA E ÇMIMEVE NË SHQIPËRI NË KRAHASIM ME
GREQINË DHE ITALINË. ÇFARË MUND TË THEMI PËR
KONVERGJENCËN?
ELVANA TROQE dhe VALENTINA SEMI, specialiste,
Departamenti i Politikës Monetare.

Një nga kriteret kryesore për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe më pas në atë Monetar (EMU) është ai i stabilitetit të çmimeve. Sipas këtij kriteri, norma e inflacionit nuk duhet të jetë më e madhe se 1.5 pikë përqindje nga mesatarja e tre vendeve anëtare të BE-së, që kanë performancën më të



mirë në terma të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, gjatë vitit që paraprind ekzaminimin e situatës në atë vend. Meqenëse një nga objektivat e Shqipërisë është ai i anëtarësimit në BE, në këtë material shqyrtohet tendenca e çmimeve në vend, në krahasim me çmimet e Greqisë dhe të Italisë, si dy nga partnerët tregtarë kryesorë të Shqipërisë.

Për të krahasuar ecurinë e çmimeve midis Shqipërisë nga njëra anë, dhe Italisë e Greqisë nga ana tjetër, në mungesë të të dhënave për vlerat absolute të çmimeve, janë marrë për bazë seritë e të dhënave të indekseve të çmimeve të konsumit. Konkluzioni më i rëndësishëm i këtij materiali është, se në asnjë rast nuk është konstatuar divergjencë në normat e inflacionit për të 12 grupet e indeksit të çmimeve të konsumit, midis Shqipërisë dhe dy vendeve të tjera, Italisë dhe Greqisë.

Buletini Ekonomik - Vëllimi 10, nr. 2, qershor 2007

LIGJI I RI "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" DHE PËRPUTHSHMËRIA E TIJ ME KUADRIN RREGULLATIV MBIKËQYRËS. DETYRIMET PËR NDRYSHIME RREGULLATIVE NË ZBATIM TË DIREKTIVAVE TË BASHKIMIT EVROPIAN. JUNA BOZDO dhe IRINI KALLUCI, specialiste, Zyra e Kërkimit dhe Konsistencës, Departamenti i Mbikëqyrjes.

Artikulli trajton përputhshmërinë e ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" me kuadrin rregullativ mbikëqyrës ekzistues si dhe detyrimet për ndryshime rregullative, që lindin nga zbatimi i dispozitave të Direktivës 2000/12/BE të konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE.

Përgjatë materialit bëhet krahasimi ndërmjet ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën



e Shqipërisë” me ligjin nr.8365, datë 02.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka shërbyer si bazë për hartimin e kuadrit rregullativ mbikëqyrës ekzistues. Nga një analizë e detajuar e neneve të këtyre ligjeve dhe nga krahasimi i tyre me rregulloret në të cilat reflektohen, është arritur në përfundimin se disa prej rregulloreve ekzistuese kanë nevojë për një rikonceptim, me qëllim reflektimin e risive që lindin nga zbatimi i kuadrit të ri ligjor. Element plotësues i kësaj analize është dhe reflektimi i dispozitave të Direktivës 2000/12/BE të konsoliduar me Direktivën 2006/48/BE, për të përfshirë detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit në fushën e veprimtarive financiare.

AKTIVITETI KREDITUES: MUNGESA DHE PRURJET E NJË FAKTORI TË RËNDËSISHËM ZHVILLIMI.

ELONA BOLLANO, specialiste, Departamenti i Politikës Monetare;
GEROND ZIU, specialist, Departamenti i Mbikëqyrjes.

Kreditimi, aktiviteti që qëndron në bazë të zhvillimit të sistemit bankar, ka marrë një hov të madh gjatë viteve të fundit. Zhvillimet në sistemin bankar pritet të përçohen edhe në sektorin real të ekonomisë. Duke ofruar më shumë produkte dhe shërbime, bankat ndihmojnë klientët e tyre në procesin e kursimit dhe të investimit duke nxitur kështu rritjen ekonomike. Gjithashtu, sistemi bankar mund të përmirësojë ambientin ku veprojnë firmat vendase dhe të huaja si dhe të nxisë ardhjen e kapitalit të huaj në vend. Por, nga ana tjetër, rritja e madhe e kredisë rrit shkallën e rrezikut. Rreziqet janë të lidhura jo vetëm me institucionin që e ndërmerr këtë aktivitet, por mund të përçohen edhe në ekonomi. Në këto kushte, artikulli tenton të evidentojë mundësitë dhe rreziqet që paraqiten me qëllim hartimin e politikave të



duhura, për të përfituar sa më shumë prej mundësive dhe për të eliminuar apo kufizuar rreziqet.

Buletini Ekonomik - Vëllimi 10, nr. 3, shtator 2007

INFORMACION MBI REZULTATET E VROJTIMIT PRANË FAMILJEVE
ARGITA FRASHËRI, Përgjegjëse e Zyrës së Bilancit të
Pagesave, Departamenti i Statistikës.

Dukuria social-ekonomike e emigrimit të punës është tashmë një fakt në jetën e përditshme të shqiptarëve. Megjithatë, pavarësisht studimeve të shumta mbi ndikimin social, demografik dhe ekonomik të emigracionit, ende ka një njohje pjesore të dërgesave në para të emigrantëve, remitançave, në Shqipëri. Pak dihet rreth karakteristikave, dinamikës, ecurisë dhe ndikimit të këtyre dërgesave në nivele personale, familjare dhe komuniteti. Synimi kryesor i Bankës së Shqipërisë është vlerësimi sa më i saktë i flukseve hyrëse të remitançave, për nevoja të hartimit të bilancit të pagesave dhe analizave të ndryshme në nivel makro. Nisur nga shkalla e lartë e informalitetit që karakterizon këto flukse, hulumtimi i tyre me vërtetim merr një rëndësi të veçantë. Ky material, duke u bazuar në një vërtetim me intervistim të përfituesve të fundit të këtyre fondeve (familjeve pritëse), sjell një kontribut shtesë në njohjen e zhvillimit të kësaj dukurie, parë nga këndvështrimi i familjeve pritëse të remitançave.

ÇMIMET E PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE STABILITETI
FINANCIAR.

JUNA BOZDO, specialiste, Zyra e Analizave Ekonomike,
Departamenti i Mbikëqyrjes.

Huadhënia bankare është burimi kryesor i financimit të pasurive të paluajtshme. Dekadën e fundit

përputhshmëria midis cikleve në kredidhënie dhe ecurisë së tregjeve të pasurive të paluajtshme, që dëshmojnë për një lidhje të ngushtë ndërmjet tyre, kanë qenë gjerësisht të dokumentuara nga literatura. Sidoqoftë, ndërvarësia midis kredidhënies bankare dhe çmimit të pasurive të paluajtshme mbetet ende një çështje e diskutueshme.

Artikulli shqyrton huadhënien për pasuri të paluajtshme si një prej elementeve përbërëse më të rëndësishme të kredisë bankare në tërësi, duke analizuar trajtimin e saj nga pikëpamja mbikëqyrëse. Me qëllim identifikimin e llojeve të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe rreziqeve që procesi i kredidhënies për pasuri të paluajtshme mbart, artikulli përmban edhe rezultatet e një pyetësori, hartuar për të njohur opinionin e bankave të sistemit mbi këto çështje.

Buletini Ekonomik - Vëllimi 10, nr. 4, dhjetor 2007

PRODUKTIVITETI I PUNËS NË SHQIPËRI: PROCESI I KONVERGIMIT SEKTORIAL.
VASILIKA KOTA, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Ky punim trajton ndikimin që ka konvergimi i sektorëve në rritjen e produktivitetit të punës, gjatë periudhës 1996-2005. Me anë të studimit të rishpërndarjes së faktorit punë ndërmjet sektorëve të ekonomisë shqiptare, përcaktohet dhe ndikimi i tij në produktivitetin total të punës. Për këtë qëllim, metodologjia e zbatuar në material shpërbën faktorët e rritjes së produktivitetit agregat të punës, në kontributin e tre faktorëve: rritja brenda sektorit e produktivitetit të punës, rishpërndarja e punësimit midis sektorëve dhe konvergjenca e sektorëve drejt një niveli mesatar produktiviteti, i cili mund të konsiderohet si niveli ekuilibër. Rezultatet tregojnë se



procesi i konvergimit është mjaft pranishëm për sektorin e bujqësisë, ndërkohë që sektorët e tjerë tentojnë drejt një pike të lartë ekuilibri. Gjithsesi, zhvillimet sektoriale mbështesin rritjen e vazhdueshme të produktivitetit të punës në Shqipëri.

METODAT KRYESORE TË DISAGREGIMIT TË PËRKOHSHËM.
ELONA DUSHKU, specialiste, Departamenti i Kërkimeve.

Shumë seri kohore janë të vëzhguara vetëm në frekuencë të ulët (për shembull vjetore), ndërkohë që pjesa më e madhe e analizave ekonomike studiojnë sjelljen e ekonomisë në periudhat afatshkurtra, duke rritur në këtë mënyrë kërkesën për të dhëna me frekuencë më të lartë. Procesi i derivimit të të dhënave me frekuencë të lartë nga të dhënat me frekuencë të ulët, njihet si procesi i disagregimit të përkohshëm. Ky është një proces mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm sidomos në rastet kur ka një mungesë të madhe informacioni, pasi bën të mundur shtimin e serive, vlerësimin e vlerave të panjohura dhe përmirëson analizat ekonomike afatshkurtra. Për të disagreguar seritë mund të përdoren metoda të ndryshme, të cilat varen kryesisht nga informacioni që kemi në lidhje me një variabël të caktuar. Në këtë material është bërë përpjekja e parë e gjenerimit të PBB-së tremujore nga dy seri, ajo e M3-shit dhe e vëllimit total të shitjeve.

MATERIALE DISKUTIMI

KONKURRENCA NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR.
SOFIKA NOTE, specialiste, Departamenti i Kërkimeve

Konkurrenca është një aspekt i rëndësishëm për sistemin bankar sepse, si në çdo treg, ajo ndikon eficiencën dhe



cilësinë e produkteve të ofruara. Për më tepër, niveli i konkurrencës në sistemin bankar ka implikime edhe për sektorë të tjerë të ekonomisë. Ky studim vlerëson kushtet e konkurrencës në sistemin bankar shqiptar duke aplikuar metodologjinë Panzar-Rosse. Sipas kësaj metodologjie, konkurrenca rezulton në nivele mesatare dhe jo në nivele të ulëta, siç mund të kuptohet nga treguesit e përqendrimit të tregut. Rezultatet tregojnë se bankat shqiptare operojnë në një ambient me konkurrencë monopolistike; ato diferencohen nga njëra-tjetra sipas tregut dhe/ose produktit. Nga krahasimi me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian, ky nivel konkurrence mund të gjykohet si i kënaqshëm, duke patur parasysh shkallën e zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Gjithashtu, analiza krahasimore mbështet evidencën empirike se një përqendrim më i lartë në treg nuk nënkupton detyrimisht një nivel më të ulët konkurrence.

BEŞIMI KONSUMATOR DHE EKONOMIA SHQIPTARE - NJË URË E RE INFORMACIONI.

DORIANA LAMA, Përgjegjëse e Zyrës së Tregjeve në Sektorin Financiar, Departamenti i Politikës Monetare.

KLODIANA ISTREFI, Kryespecialiste, Zyra e Çështjeve Monetare, Sektori Financiar, Departamenti i Politikës Monetare.

Ky material synon të prezantojë lexuesin me vrojtimin tremujor të Besimit të Konsumatorit në Shqipëri dhe rezultatet që ka treguar ai, që nga fillimi i kryerjes së vrojtimit në vitin 2003. Në material diskutohet metodologjia për ndërtimin e Treguesit të Besimit të Konsumatorit, produkti kryesor i vrojtimit, i cili përdoret për të identifikuar ndryshime në ndjesinë e konsumatorit ndaj zhvillimit ekonomik të vendit. Metodologjia e diskutuar është e njëjtë me atë që praktikohet nga vendet



e Bashkimit Evropian, duke siguruar një bazë krahasimi me këto vende. Të dhënat katërvjeçare, të përfuara nga Vrojtimi i Konsumatorit, janë testuar për konsistencën në kohë me disa tregues realë të ekonomisë. Në përgjithësi, ka rezultuar se përfundimet e vrojtimin janë në të njëjtën linjë me zhvillimet në disa aspekte të ekonomisë. Treguesi i Besimit të Konsumatorit dhe rezultate të tjera të vrojtimin kanë arritur të kapin ndryshimet në tendencën e rritjes ekonomike, të rritjes së të ardhurave dhe të rritjes së konsumit. Gjithashtu, seria e të dhënave faktike për inflacionin dhe pritjet inflacioniste të konsumatorit, përputhen në ecuri.

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT: ASPEKTE
METODOLOGJIKE DHE ANALIZË EKONOMIKE E
REZULTATEVE.

DIANA SHTYLLA, Përgjegjëse e Sektorit të Ekonomisë,
Departamenti i Politikës Monetare.
EVELINA ÇELIKU, Kryespecialiste, Sektori i Ekonomisë,
Departamenti i Politikës Monetare.

Ky studim paraqet një trajtim të gjerë të metodologjisë dhe një analizë ekonomike të detajuar të rezultateve të Vrojtimin të Besimit të Biznesit të organizuar nga Banka e Shqipërisë. Metodologjia e vrojtimin është trajtuar duke ndjekur parimet teorike dhe praktike të Vrojtimeve të Tendencës së Biznesit, të organizuara në vendet e OECD-së. Analiza ekonomike e rezultateve të vrojtimin ka për qëllim të kontrollojë shkallën e përshtatshmërisë së treguesve të dalë nga vrojtimi, si mjete ndihmëse në procesin e vlerësimit të ecurisë së treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri si edhe në atë të parashikimit afatshkurtër të tyre. Nga studimi, rezulton se treguesit e besimit të biznesit shpjegojnë në mënyrë të kënaqshme ecurinë e serisë së referencës. Për këtë arsye, ata mund



të përdoren në mënyrë relativisht të besueshme për të identifikuar dhe për t'iu paraprirë pikave të kthesës në aktivitetin ekonomik në vend.

BOTIME TË TJERA TË BANKËS SË SHQIPËRISË

METODIKA E BILANCIT TË PAGESAVE

Ashtu si dhe në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës, Banka e Shqipërisë është institucioni përgjegjës për hartimin e statistikave të bilancit të pagesave në Shqipëri. Kjo metodikë e publikuar nga Banka e Shqipërisë ka për qëllim të përshkruajë konceptet, parimet dhe standardet për hartimin dhe leximin e statistikave të bilancit të pagesave. Këto statistika përbëhen nga një grup pasqyrash të cilat përmbledhin në mënyrë sistematike, për një periudhë të caktuar kohe, transaksionet ekonomike të një vendi me botën që e rrethon, të cilat në shumicën e rasteve ndodhin ndërmjet rezidentëve e jorezidentëve.

Statistikat e bilancit të pagesave përveçse përshkruajnë zhvillimet në pozicionin e jashtëm të një ekonomie, luajnë një rol shumë të rëndësishëm si tregues të gjendjes së ekonomisë. Veçanërisht kjo, në ato vende që ndjekin një politikë monetare të pavarur, duke shërbyer deridiku edhe si një test mbi efektshmërinë e politikave të ndjekura në ekonominë e brendshme.

LIGJI NR. 9662, DATË 18.12.2006 "PËR BANKAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Ligji i ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", sipas përcaktimit në nenin 1 të tij, ka për objekt vendosjen e kushteve dhe të rregullave për krijimin, licencimin,



organizimin, drejtimin, kujdestarinë dhe likuidimin e bankave, të degëve të bankave të huaja, ushtrimin e veprimtarisë bankare si dhe mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj synon modernizimin e legjislacionit bankar në Shqipëri, me qëllim harmonizimin e tij me të drejtën komunitare. Ai merr në konsideratë detyrimet e Shqipërisë, që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit në fushën e shërbimeve financiare, në përgjithësi dhe atyre bankare, në veçanti, të cilat kanë të bëjnë me lirinë e themelimit dhe lirinë për të ofruar shërbime bankare dhe financiare. Ligji është harmonizuar gjithashtu, edhe me direktivat kodifikuese të Bashkimit Evropian në fushën e të drejtës bankare, si dhe me Parimet Thelbësore të Bazelit.

BOTIME EDUKATIVE

PARAJA ELEKTRONIKE: E ARDHMJA E PARASË?

Modernizimi i sistemit bankar ofron mundësi të shumta për mënjanimin e përdorimit të parasë cash. Një prej këtyre mundësive është përdorimi i parasë elektronike. Për të krijuar një ide më të qartë mbi këtë mundësi, Banka e Shqipërisë i ofron të gjithë përdoruesve të cash-it informacion bazë mbi këtë formë të re të parasë, avantazhet, disavantazhet e saj dhe mënyrat e ndryshme të përdorimit.

BANKA E SHQIPËRISË – BANKA JONË QENDRORE

Nëpërmjet një panorame të përgjithshme të historisë, strukturës dhe funksioneve të bankës qendrore, kjo broshurë i prezanton publikut Bankën e Shqipërisë. Si e realizon Banka e Shqipërisë objektivin e stabilitetit të çmimeve, si kontribuon ajo, me politikat e saj, në zhvillimin

ekonomik dhe në mirëqenien e vendit dhe të tjerave pyetje si këto, do t'u jepet përgjigje duke shfletuar këtë botim.

ABC-JA E NORMAVE TË INTERESIT

Çfarë janë normat e interesit dhe pse luhaten ato? Kur është momenti i duhur për të investuar, kur duhet kursyer, dhe në ç'moment është më e këshillueshme të marrim një kredi? Të gjitha këtyre pyetjeve, i jep përgjigje kjo broshurë, e cila tregon se si normat e interesit kanë fuqinë të ndikojnë jetët e njerëzve. Për të shkuar dhe më larg, duke ndikuar vendimet ekonomike që individët e ndryshëm marrin, normat e interesit shërbejnë edhe si faktor përcaktues për investimet në nivelin e përgjithshëm të ekonomisë.

BANKAT NË EPOKËN E INTERNETIT

Internet banking ose mundësia e përdorimit të shërbimeve bankare nëpërmjet internetit, ka sjellë pa dyshim një evolucion në sistemin bankar. Ai ka bërë të mundur "krijimin" e një filiali banke në shtëpinë e gjithsecilit. Në Shqipëri, internet banking është akoma në hapat e tij të parë. Kjo është një arsye më shumë, përse Banka e Shqipërisë ka përgatitur botimin, nëpërmjet të cilit përpiqet të prezantojë këtë shërbim; përparësitë që ai ofron dhe kujdesin e veçantë që duhet treguar gjatë përdorimit të tij.

NDËRTONI TË ARDHMEN – PLANIFIKONI TË ARDHURAT TUAJA

Ky libër është ideuar dhe shkruar për t'i ardhur në ndihmë publikut të gjerë në organizimin financiar të



jetës së përditshme; në administrimin sa më të mirë të të ardhurave personale; në orientimin drejt mënyrave më të përshtatshme për të shtuar kursimet apo për të rritur fitimet.

GODINA E BANKËS SË SHQIPËRISË

Kjo broshurë bën një përshkrim të godinës së Bankës së Shqipërisë. Historisë së ndërtimit të saj. Jetës dhe punës së arkitektit që e ka projektuar. Godina është rreth 70-vjeçare. E vendosur në qendër të Tiranës, ajo është një ndër ndërtesat simbol të kryeqytetit. Së shpejti, godina do të jetë objekt i një rregullimi e rinovimi të përgjithshëm. Kjo do të synojë ta shndërrojë në një ambient pune të përshtatshëm e komod për personelin e Bankës, pa çenuar identitetin dhe vlerat e saj arkitekturore.

REGJISTRI I KREDIVE (FLETËPALOSJE)

Regjistri i Kredive është një bazë me të dhëna dhe informacione demografike dhe mbi angazhimet financiare, reale të personave që aplikojnë për kredi pranë një banke, dege të një banke të huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë apo pranë institucioneve të tjera kredidhënëse.

ÇFARË ËSHTË RAPORTI PËR KREDIMARRËSIN?

Nga data 3 janar 2008, në Bankën e Shqipërisë filloi funksionimin Regjistri i Kredive, si baza elektronike e të dhënave për kredimarrësit e sistemit bankar. Kjo broshurë prezanton publikun me produktin kryesor të gjeneruar nga Regjistri i Kredive, që është Raporti për Kredimarrësin. Një raport i tillë përmban informacion



financiar mbi individët apo personat juridikë që kanë aplikuar për kredi në sektorin bankar dhe në këtë mënyrë, ndihmon bankat të marrin vendime më të mira në lidhje me kredidhënien.

INFLACIONI I SHËNJESTRUAR 2 – TRYEZË E RRUMBULLAKËT, TIRANË, 7-8 DHJETOR 2006

FJALË PËRSHËNDETËSE

FATOS IBRAHIMI, Zëvendësguvernator i Parë, Banka e Shqipërisë

MefjalënehapjessëkësajTryeze, Zëvendësguvernatori i Parë i Bankës së Shqipërisë, z. Ibrahim, duke i uruar mirëseardhjen të ftuarve të huaj dhe vendas, i njuh të pranishmit me axhendën e aktivitetit dhe i fton ata të marrin pjesë aktive në diskutimet e ditëve në vijim.

INFLACIONI I SHËNJESTRUAR, RASTI I SHQIPËRISË.
UDHËZUES PËR ZBATIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

ERALD THEMELI, Zëvendësdrejtor, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë;
GRAMOZ KOLASI, Drejtor, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

Regjimi i inflacionit të shënjestruar, të cilin Banka e Shqipërisë synon ta adoptojë si regjimin e ardhshëm të politikës së saj monetare, do të shërbejë si një kornizë më e mirë për integrimin e të gjithë informacionit të nevojshëm për vendimmarrjen e politikës monetare, si dhe do të ofrojë një mjet më të mirë komunikimi për politikën monetare. Ky material, tenton të paraqesë një përmbledhje të punës së kryer në këtë drejtim, si dhe të detyrave dhe sfidave të të ardhmes, për optimimin e inflacionit të shënjestruar në Shqipëri.



KOMENTE MBI: INFLACIONI I SHËNJESTRUAR, RASTI I SHQIPËRISË. UDHËZUES PËR ZBATIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

MARKO ŠKREB, ish-Gubernator, Banka Kombëtare e Kroacisë

Duke vlerësuar përparimet që Banka e Shqipërisë ka bërë në përgatitjet për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar dhe në të kuptuarit e politikës monetare, z. Škreb thekson mendimin e tij se realitetit shqiptar do t'i përshtatej më mirë një kuadër "hibrid" i politikës monetare. Në kushtet e tanishme, një regjim i pastër i inflacionit të shënjestruar nuk është i përshtatshëm për Shqipërinë dhe as një regjim fiks i monedhës nuk është një zgjedhje e mirë.

KOMENTE MBI: INFLACIONI I SHËNJESTRUAR, RASTI I SHQIPËRISË. UDHËZUES PËR ZBATIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

DAVID G MAYES, Banka e Finlandës dhe Universiteti i Auckland

Rruga e duhur për t'u ndjekur, në periudhën afatmesme, për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar është ajo e adoptimit të metodave që janë provuar më parë nga bankat e tjera qendrore. Deri tani, edhe pse Shqipëria nuk ka arritur disa nga parakushtet për një shënjestrim të suksesshëm të inflacionit, përjasja e kujdesshme që po ndjek Banka e Shqipërisë përbën bazën e nevojshme drejt këtij regjimi.

MODELI MAKROEKONOMETRIK PËR SHQIPËRINË.

ELONA DUSHKU, VASILIKA KOTA dhe GËZIM BINAJ,
specialistë, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Në këtë material, bëhet një përpjekje e parë për ndërtimin e një modeli makroekonomik për Shqipërinë, i



quajtur MEAM. Për këtë, autorët kanë ndërtuar identitetet kryesore që duhen përmbushur në një ekonomi dhe kanë modeluar kanalet kryesore të transmetimit, nëpërmjet këtyre identiteteve dhe ekuacioneve të vlerësuara. Qëllimi kryesor i tij është ndërtimi i një mjeti analitik, i cili nëpërmjet simulimeve të ndryshme të jetë në shërbim të analizave makroekonomike dhe monetare, për të ndihmuar procesin e vendimmarrjes së politikës monetare në Bankën e Shqipërisë.

KOMENTE MBI: MODELI MAKROEKONOMETRIK PËR SHQIPËRINË.

DAVID G MAYES, Banka e Finlandës dhe Universiteti i Auckland

Modeli makroekonomik (MEAM) është pa diskutim, pjesë e një projekti kërkimi, që ka filluar duke studiuar se çfarë mund të rezultojë nga përdorimi i një metode të mirëformuluar për vlerësimin e marrëdhënieve kryesore në një ekonomi. Z. Mayes vlerëson se në formën aktuale, ky model mund të përdoret për disa lloj parashikimesh, por nuk është ende në gjendje të ndihmojë shumë në analizat e politikës monetare.

KOMENTE MBI: MODELI MAKROEKONOMETRIK PËR SHQIPËRINË.

GÛLBIN ŞAHINBEYOĞLU, Zëvendës drejtor, Departamenti i Kërkimeve dhe i Politikës Monetare, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë

Materiali i përgatitur nga Dushku etj. (2006) është një përpjekje e parë mjaft ambicioze, duke qenë se vendi po përballet me ndryshime të shpejta strukturore për shkak të kalimit nga një ekonomi tranzicioni në një ekonomi tregu dhe se cilësia e statistikave është mjaft e



ulët. Kjo përpjekje e parë duhet lavdëruar, pasi tregon vendosmërinë e Bankës së Shqipërisë për të adoptuar regjimin e inflacionit të shënjestruar dhe përpjekjet e saj për të përmbushur kushtet teknike përpara zbatimit të tij.

PORTOFOLI I MODELEVE EKONOMETRIKE PËR PARASHIKIMIN E INFLACIONIT NË BANKËN E SHQIPËRISË.
EVELINA ÇELIKU, DIANA SHTYLLA, GENT HASHORVA,
RAJNA HÖXHOLLI, Departamenti i Politikës Monetare,
Banka e Shqipërisë,
VASILIKA KOTA, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

Objektivi i këtij materiali, është të paraqesë zhvillimin e serisë së modeleve ekonometrike, të përdorura për parashikimin e inflacionit në Bankën e Shqipërisë. Modelet e parashikimit të inflacionit, kanë një rëndësi jo vetëm për procesin e parashikimit, por ato së bashku me modelin makroekonomik, mund të përdoren për të kuptuar edhe më mirë dinamikën e ekonomisë shqiptare. Duke filluar nga tremujori i dytë i vitit 2005, po përdoren tre modele me frekuencë mujore dhe tre të tjera, me frekuencë tremujore.

KOMENTE MBI: PORTOFOLI I MODELEVE EKONOMETRIKE PËR PARASHIKIMIN E INFLACIONIT NË BANKËN E SHQIPËRISË.
RONALD ALBERS, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare, Komuniteti Evropian

Progresi i bërë nga Banka e Shqipërisë në ndërtimin e kapaciteteve teknike për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar është shumë inkurajues. Vendimi për të zgjatur periudhën përgatitore është i drejtë, pasi mundëson zhvillimin e mëtejshëm të parashikimeve dhe



të kapaciteteve monitoruese, si dhe një vlerësim më të mirë të besueshmërisë së parashikimeve. Megjithatë, faza aktuale e parashikimit të inflacionit lë vend për shumë pyetje pa përgjigje.

KOMENTE MBI: PORTOFOLI I MODELEVE EKONOMETRIKE PËR PARASHIKIMIN E INFLACIONIT NË BANKËN E SHQIPËRISË.

BILL ALLEN, Ekonomist i Lartë, Brevar Howard Asset Management LLP dhe ish-Gubernurator, Banka e Anglisë

Z. Allen në komentin e tij mbi materialin e Çeliku etj. rendit një sërë analizash e rekomandimesh për përmirësime të procesit të vlerësimit të parashikimit. Faktet që autori përmend, lënë të kuptohet se ndonëse ekuacionet për parashikimin e inflacionit të përshkruara në material kanë rolin e tyre në hartimin e politikës monetare, ky rol është gjithsesi i kufizuar. Për të patur një politikë të suksesshme monetare në Shqipëri, do të nevojitej dhe përdorimi i arsytimit njerëzor.

NJË PROPOZIM PËR STRATEGJINË E KOMUNIKIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË LIDHUR ME INFLACIONIN E SHËNJESTRUAR.

INA KRAJA, Drejtore, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit;
ERINDA NERVAJ dhe RIGERS KASO, specialistë, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Evropian dhe Komunikimit;
DORIANA LAMA, Përgjegjëse e Zyrës së Tregjeve, Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë;
MARGA PEETERS, këshilltare e FMN në Bankën e Shqipërisë për politikën monetare

Ky material paraqet strategjinë e Bankës së Shqipërisë për komunikimin e inflacionit të shënjestruar. Strategjia



përkufizon si objektiv të saj rritjen, zhvillimin dhe arritjen e ndërgjegjësimit të publikut, lidhur me çështjet e politikës monetare në përgjithësi dhe me regjimin e inflacionit të shënjestruar, në veçanti. Duke bërë dallimin ndërmjet periudhës para dhe pas adoptimit të këtij regjimi, strategjia propozon një adoptim gradual të inflacionit të shënjestruar dhe një dialog intensiv të bankës qendrore me segmente të ndryshme të publikut.

KOMENTE MBI: NJË PROPOZIM PËR STRATEGJINË E KOMUNIKIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË LIDHUR ME INFLACIONIN E SHËNJESTRUAR.

GÛLBIN ŞAHINBEYOĒLU, Zëvendës drejtoreshë, Departamenti i Kërkimeve dhe i Politikës Monetare, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë

Duke u nisur nga rëndësia e një strategjie komunikimi eficiente në regjimin e inflacionit të shënjestruar, kjo përpjekje e autorëve merr një rëndësi të madhe. Kështu, materiali i Nervaj etj. bën një përpjekje të vlefshme për të përcaktuar kontekstin dhe qëllimin e strategjisë së komunikimit të Bankës së Shqipërisë, si dhe luan një rol qendror në krijimin e transparencës së nevojshme për këtë regjim. Duke parë në perspektivë, sqarimi i mëtejshëm i formës përfundimtare të regjimit të inflacionit të shënjestruar që Banka e Shqipërisë synon të zbatojë, si dhe përcaktimi i kohës së fillimit të zbatimit të tij, do të ndihmonte plotësimin e strategjisë së komunikimit.

PËRMIRËSIMET NË KUADRIN STATISTIKOR PËR INFLACIONIN E SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

HILDA SHIJAKU, Përgjegjëse e Sektorit të Statistikave Financiare, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë
KLITI CECA, Drejtor, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë

EVIS RUÇI, Nëndrejtorë dhe Përgjegjëse e Sektorit të Bilancit të Pagesave, Departamenti i Statistikës, Banka e Shqipërisë

Autorët, me studimin e tyre, paraqesin një tablo të kuadrit aktual statistikor në Shqipëri dhe tregojnë planet për plotësimin e boshllëqeve aktuale dhe për pjesëmarrjen e Shqipërisë në projektin SDDS, në fund të vitit 2007. Parakushtet e inflacionit të shënjestruar lidhur me statistikën, krahas një liste të gjatë të serive ekonomike të nevojshme për modelimin, parashikimin dhe komunikimin me publikun, mbulojnë kuadrin e duhur ligjor dhe institucional, që mbështet pavarësinë profesionale, një transparencë më të madhe dhe besimin e publikut në të dhënat e përdorura nga vendimmarrësit.

KOMENTE MBI: PËRMIRËSIMET NË KUADRIN STATISTIKOR PËR INFLACIONIN E SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

HENNING AHNERT, Përgjegjës i Sektorit të Statistikave të Përgjithshme Ekonomike, Banka Qendrore Evropiane

Një bazë e mirë statistikore është parakusht për drejtimin e politikës monetare, në të gjitha vendet dhe në të gjitha zonat ekonomike. Kumtesa e z. Ahnert jep komente të hollësishme mbi zhvillime të veçanta statistikore, duke u ndalur më shumë tek puna e bërë mbi indeksin e çmimit të konsumit në Shqipëri dhe mbi parimet “e qeverisjes” lidhur me statistikën.

KOMENTE MBI: PËRMIRËSIMET NË KUADRIN STATISTIKOR PËR INFLACIONIN E SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

BILL ALLEN, Ekonomist i Lartë, Brevan Howard Asset Management LLP dhe ish-Gubernur, Banka e Anglisë

Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme statistikore është ndoshta, pjesa më e vështirë e detyrës me të cilën



po përballet Shqipëria, gjatë përgatitjes për adoptimin e regjimit të inflacionit të shënjestruar. Materiali i prezantuar e bën të qartë, se Banka e Shqipërisë po i afrohet këtij procesi në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe mjaft koherente, dhe autori shprehet i befashuar me progresin e arritur gjatë vitit të fundit. Ai beson se për rastin e Shqipërisë, është më mirë të bazohet mbi infrastrukturën aktuale statistikore, se sa të ndërtojë një të tillë nga e para.

E ARDHMJA E RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE NË KUADRIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR.

DIANA SHTYLLA, Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik,
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë
ERJONA SULJOTI, Përgjegjëse e Zyrës Monetare,
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

Qëllimi i këtij materiali është paraqitja e një tabloje të përgjithshme të Raportit të Inflacionit të Bankës së Shqipërisë, si një element themelor i strategjisë së komunikimit, që paraprin dhe pason regjimin e inflacionit të shënjestruar. Raporti i Inflacionit perceptohet si një dokument periodik, i cili do të informojë publikun mbi zhvillimet e fundit të inflacionit, do të paraqesë parashikimet e tij, do të komunikojë dhe shpjegojë vendimet e politikës monetare, si dhe do të japë llogari lidhur me vendimet e marra në të kaluarën.

KOMENTE MBI: E ARDHMJA E RAPORTIT TË POLITIKËS MONETARE NË KUADRIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR.

DAVID G MAYES, Banka e Finlandës dhe Universiteti i Auckland

Propozimet lidhur me Raportin e Inflacionit janë mjaft të detajuara dhe pasqyrojnë mendime dhe përpjekje



që duhen lavdëruar, ndonëse ato konsiderohen njëkohësisht nga autori si disi fizikisht të paprekshme. Për këtë arsye, është relativisht e vështirë të bëhet një vlerësim mbi pamjen që do të ketë, përveçse të pritet zhvillimi i tij nga Raporti aktual i Politikës Monetare. Ekziston një shumëllojshmëri raportesh e do të jetë me interes të shikojmë, se cilat karakteristika dhe veçori do të zgjidhen nga Banka e Shqipërisë për aplikim.

KOORDINIMI MIDIS BANKËS QENDRORE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE NËN REGJIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR.

ERJON LUÇI, Drejtor, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë,

MARIAN GJERMENI, Drejtor, Departamenti i Operacioneve Monetare, Banka e Shqipërisë, ANJEZA GAZIDEDE, Specialiste, Departamenti i Operacioneve Monetare, Banka e Shqipërisë

Ky material diskuton çështjet, që lidhen me koordinimin midis bankës qendrore dhe Ministrisë së Financave, si dhe përpiqet të identifikojë ato fusha ku ka vend për përmirësime të mëtejshme, të cilat mund të jenë në përfitim të të dyja palëve. Autorët e studimit janë përqendruar në tre çështje kryesore: (1) koordinimi midis politikës monetare dhe asaj fiskale; (2) bashkëpunimi në arritjen e qëllimeve të përbashkëta në fushat e tjera; dhe (3) shkëmbimi i informacionit.

KOMENTE MBI: KOORDINIMI MIDIS BANKËS QENDRORE DHE MINISTRISË SË FINANCAVE NËN REGJIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR.

LUCIA QUAGLIA, Universiteti i Sussex

Në komentin e saj për materialin e prezantuar nga Luçi etj., zj. Quaglia përqendrohet kryesisht në grupin



e çështjeve, që lidhen me koordinimin makroekonomik. Folësja zgjedh për analizën e saj, një perspektivë krahasuese dhe historike, me qëllim nxjerrjen e mësimëve të dobishme nga përvoja e shteteve të tjera evropiane, si Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia.

ÇËSHTJET LIGJORE LIDHUR ME ZBATIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

TONI GOGU, Drejtor, Departamenti Juridik, Banka e Shqipërisë
ELIS TARELLI, Këshilltar, Kabineti i Guvernatorit, Banka e Shqipërisë

Ky material studion faktin nëse kuadri aktual ligjor plotëson disa prej kushteve të nevojshme për zbatimin me sukses të regjimit të inflacionit të shënjestruar. Autorët arrijnë në përfundimin se, ndonëse ka vend për ndryshime në kuadrin ligjor, me qëllim përmirësimin e kushteve të nevojshme për zbatimin e inflacionit të shënjestruar, kuadri aktual ligjor ofron mjaft për fillimin e zbatimit të tij.

KOMENTE MBI: ÇËSHTJET LIGJORE LIDHUR ME ZBATIMIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR NË SHQIPËRI.

RONALD ALBERS, Drejtorja e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare, Komuniteti Evropian

Në kumtesën e tij, z. Albers shprehet se materiali i prezantuar nga Gogu dhe Tarelli paraqet një tablo të gjerë të progresit ligjor, si dhe disa çështje që ende duhen zgjidhur. Duke vlerësuar synimin e Bankës së Shqipërisë për standarde të larta ligjore, si dhe përpjekjet e saj për të patur si pikë referimi praktikat më të mira të aplikuar, ai gjykon se me të drejtë, ka mjaft



liri veprimi përsa i përket zbatimit të saktë të inflacionit të shënjestruar. Përvoja e vendeve të tjera, ka dëshmuar se ky regjim mund të jetë i suksesshëm në kuadro të ndryshëm ligjorë dhe institucionalë.

FJALA MBYLLËSE
ARDIAN FULLANI, Guvernator, Banka e Shqipërisë

Në fjalën e tij të mbylljes së Tryezës së Rrumbullakët mbi Inflacionin e Shënjestruar 2, Guvernatori Fullani pas falenderimit të pjesëmarrësve për kontributin e tyre në diskutime, theksoi sërish angazhimin e Bankës së Shqipërisë për vlerësimin me kujdes të të gjitha mundësive për zbatimin e regjimit formal të inflacionit të shënjestruar, në periudhën afatmesme. Kjo strategji do të rrisë efektivitetin e politikës monetare, duke konsoliduar më tej stabilitetin e çmimeve dhe duke kontribuar në një rritje të qëndrueshme të ekonomisë shqiptare.

KONFERENCA VII "STRATEGJITË E POLITIKËS MONETARE PËR EKONOMITË E VOGLA", TIRANË, 6-7 DHJETOR 2007

FJALA E MIRËSEARDHJES
ARDIAN FULLANI, Guvernator, Banka e Shqipërisë

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë në fjalën e tij të hapjes theksoi se përfundimi i programit me FMN-në, nxjerr në dukje sfida të reja institucionale për autoritetet shqiptare. Është kjo arsyeja që Banka e Shqipërisë, prej kohësh është angazhuar në një proces të gjithanshëm të studimit dhe të përzgjedhjes së alternativave më të mira. Gjatë këtyre tre viteve, janë shkëmbyer ide dhe janë studiuar në imtësi tiparet e regjimit të inflacionit të shënjestruar. Përrrjedhojë, dhe mbështetur edhe në nivelin



aktual e të pritshëm të zhvillimit të tregjeve financiare, z. Fullani u shpreh i bindur se inflacioni i shënjestruar është një alternativë optimale për të ardhmen.

KOMBINIMI I POLITIKAVE TË QËNDRUESHME NË VENDET KANDIDATE DHE VENDET E MËNDSHME KANDIDATE PËR NË BE.

PETER GRASMANN, Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ekonomike dhe Financiare (DG ECFIN), Komisioni Evropian

Duke theksuar rolin e Bashkimit Evropian si një partner aktiv në procesin e tranzicionit, zhvillimit dhe përafrimit me BE për të gjitha vendet candidate dhe të mundshme candidate, z. Grasmann vlerësoi progresin e bërë nga vendet e rajonit drejt anëtarësimit në BE. Megjithatë, stabiliteti makroekonomik i arritur duhet të jetë i qëndrueshëm dhe kombinimi i politikave të orientuara drejt rritjes ekonomike, me një theks të veçantë mbi koordinimin e politikave monetare, fiskale dhe strukturore, mbetet një sfidë për të gjitha vendet.

RRITJA E KREDISË DHE MOSPËRPUTHJET E VALUTËS: CILAT JANË RREZIQËT DHE A EKZISTOJNË KURA?

BORIS VUJČIĆ*, Zëvendësguvernator, Banka Kombëtare e Kroacisë

VENDET FQINJE: SI TË ECIM NË KORSINË E SHPEJTË?

GIORGIO GOMEL, Drejtor i Departamentit të Analizave dhe Marrëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare

Evropa Qendrore dhe ajo Lindore janë aktualisht nga rajonet me rritje më të shpejtë ekonomike në botë. Ndonëse “kufijtë e shpejtësisë” për rritjen potenciale dhe flukset e kapitalit janë kryesisht të panjohur, pasojat e një kolapsi të papritur në ndonjërin prej këtyre



ekonomive do të ishin shumë të dhimbshme për të gjithë rajonin. Për të garantuar “një udhëtim të qetë në korsinë e shpejtë”, politikëbërësit duhet të reduktojnë pikat e dobëta, duke siguruar një hapësirë sigurie për çdo ndryshim të papritur në besimin e tregut.

KOMENTE MBI: KOMBINIMI I POLITIKAVE TË QËNDRUESHME NË VENDET KANDIDATE DHE VENDET E MUNDSHME KANDIDATE PËR NË BE.
RRITJA E KREDISË DHE MOSPËRPUTHJET E VALUTËS: CILAT JANË RREZIQET DHE A EKZISTOJNË KURA?
VENDET FQINJE: SI TË ECIM NË KORSINË E SHPEJTË?
MARKO ŠKREB, Kryeekonomist dhe Strateg, Banka Privredna Zagreb

Duke komentuar mbi prezantimet lidhur me Eurozonën dhe vendet fqinje, z. Škreb vë theksin mbi faktin se stabiliteti i çmimeve është një kusht i nevojshëm, por njëkohësisht shumë larg kushtit të mjaftueshëm për t’u bashkuar në mënyrë të suksesshme me BE dhe euro. Finishi i suksesit është koordinimi i politikës monetare me politikën fiskale dhe sigurisht me reformat strukturore. Dhe duke qenë se procesi nuk përfundon me hyrjen në BE (ose në euro), reformat duhet të jenë të shpejta, të thella dhe konsistente.

STRATEGJIA E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS QENDRORE EVROPIANE DHE ZGJERIMI I ZONËS SË EUROS.
MASSIMO ROSTAGNO*, Përgjegjës i Sektorit të Strategjisë së Politikës Monetare, Banka Qendrore Evropiane

STRATEGJITË E POLITIKËS MONETARE PËR EKONOMITË E VOGLA: DISA DËSHMI NGA VENDET E BE-SË NË RRUGËN DREJT BASHKIMIT EKONOMIK DHE MONETAR.
THEODOROS PAPANAYIROS, Këshilltar i Posaçëm, Banka e Greqisë

Strategjia e politikës monetare në rrugën drejt Bashkimit Ekonomik dhe Monetar duhet parë si pjesë



e një strategjie konvergjence më të gjerë, që përfshin përpjekjet për stabilitet dhe reforma. Konspekti i z. Papaspyrou ka për qëllim të analizojë elementet kryesore të strategjisë monetare të ndjekur nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian në rrugën e tyre drejt Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, si dhe të nxjerrë mësim për vendet e reja anëtare dhe ato kandidatë, në formulimin e strategjive të tyre të konvergencës dhe monetare.

KOMENTE MBI: STRATEGJIA E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS QENDRORE EVROPIANE DHE ZGJERIMI I ZONËS SË EUROS.

STRATEGJITË E POLITIKËS MONETARE PËR EKONOMITË E VOGLA: DISA DËSHMI NGA VENDET E BE-SË NË RRUGËN DREJT BASHKIMIT EKONOMIK DHE MONETAR.

BOŠTJAN JAZBEC*, Anëtar i Bordit Drejtues, Banka e Sllovenisë

POLITIKA E KURSIT TË KËMBIMIT NË EVROPËN JUGLINDORE: A KA RËNDËSI AI?

FABRIZIO CORICELLI, Drejtor i Studimeve Politike, BERZH

PETER SANFEY, Kryeekonomist, BERZH

MARKO ATANASOVSKY, Praktikant në zyrën e Kryeekonomistit, BERZH

Evropa Juglindore përbën një laborator interesant për analizat e regjimeve të kursit të këmbimit dhe efektet e tyre mbi ekonominë reale. Në këtë rajon mund të gjendet një spektër i gjerë regjimesh, që rradhiten nga euroizimi i njëanshëm në Mal të Zi, përmes bordeve të valutës në Bosnje Hercegovinë dhe Bullgari, një kurs këmbimi fiks në Republikën e Maqedonisë, dhe më pas nivele të ndryshme luhatjeje në Shqipëri, Kroaci, Rumania dhe Serbi. Pyetja që lind natyrshëm është nëse përzgjedhja e regjimit ndikon mbi zhvillimin e ekonomisë reale, apo nëse një regjim është më i mirë se një tjetër.



PËRVOJAT E FUNDIT ME REGJIMET E KURSIT TË KËMBIMIT
DHE POLITIKËN MONETARE NË EVROPËN JUGLINDORE
DHE TURQI, 2004-2007.

STEPHAN BARISITZ, Ekonomist i Lartë, Banka Kombëtare e
Austriës

Vendet e Evropës Juglindore janë përballur me shumë sfida ekonomike të ngjashme dhe kanë shfaqur ecuri ekonomike të krahaveshme. Ato ende përdorin një gamë të gjerë regjimesh dhe instrumentesh monetare dhe të kursit të këmbimit. Qëllimi kryesor i këtij materiali është të përmbledhë, të analizojë dhe të krahasojë zhvillimet e regjimeve të kursit të këmbimit dhe ato të politikës monetare në këto dhjetë vende të Evropës Juglindore: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Republika e Maqedonisë, Mal i Zi, Rumania, Serbi dhe Turqi.

PRIVATIZIMI, KONSOLIDIMI DHE ROLI NË RITJE I
BANKAVE TË HUAJA.

DUBRAVKO MIHALJEK, Ekonomist i Lartë, Banka për
Rregullime Ndërkombëtare

Ndryshimet në strukturën e sistemeve bankare të ekonomive në zhvillim ngrenë shumë sfida për ruajtjen e stabilitetit financiar në përgjithësi, si dhe për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve bankare në veçanti. Ky material trajton tre ndryshime strukturore të mëdha – privatizimin, konsolidimin dhe rolin në rritje të bankave të huaja – që kanë zënë vend në sistemet bankare të ekonomive në zhvillim, që nga viti 2000. Bazuar në treguesit standardë, materiali vlerëson sa është rritur efienca e ndërmjetësimit të sistemit bankar si rezultat i këtyre ndryshimeve.

KOMENTE MBI: POLITIKA E KURSIT TË KËMBIMIT NË
EVROPËN JUGLINDORE: A KA RËNDËSI AI?
PËRVOJAT E FUNDIT ME REGJIMET E KURSIT TË KËMBIMIT



DHE POLITIKËN MONETARE NË EVROPËN JUGLINDORE
DHE TURQI, 2004-2007.

PRIVATIZIMI, KONSOLIDIMI DHE ROLI NË RRIJJE I
BANKAVE TË HUAJA.

EDWARD OFFENBACHER*, Drejtor i Departamentit Monetar,
Banka e Izraelit

STRATEGJIA MONETARE E ZBATUAR NË KOSOVË.

MICHEL SVETCHINE, Drejtor i Përgjithshëm, Autoriteti
Qendror Bankar i Kosovës

Midis sfidave të shumta me të cilat u përball Kosova pas konfliktit të vitit 1999 ishte dhe përzgjedhja e një kuadri monetar. Për arsye të ndryshme, që lidhen kryesisht me humbjen e besimit tek dinari jugosllav dhe përdorimin e markës gjermane si instrument pagese për transaksionet dhe kursimet, u legalizua de facto dhe në mënyrë të njëanshme fillimisht përdorimi i markës gjermane dhe pas vitit 2001 i euros, si valutë zyrtare në Kosovë. Kjo nënkupton që Autoriteti Bankar Qendror i Kosovës nuk është bankë emetuese dhe se ai nuk ka në dorë instrumentet tradicionale për të zbatuar një politikë monetare në shkallë të gjerë.

INFLACIONI I SHËNJESTRUAR NË TURQI: NJË PASQYRË E
PËRVOJAVE DHE PERSPEKTIVAVE.

YUSUF SONER BAŞKAYA, Departamenti i Kërkimeve dhe
Politikës Monetare, Banka Qendrore e Republikës së Turqisë

Pas një përvoje me norma inflacioni shumë të larta dhe të paqëndrueshme për gati tre dekada me rradhë, Turqia po tregon një ecuri të jashtëzakonshme disinflacioni që nga viti 2002. Sot, norma e inflacionit në Turqi shënon numra njëshifrorë. Një vështrim nga afër i eksperiencës së Turqisë gjatë disinflacionit të fundit mund të japë njohuri të rëndësishme mbi regjimin e inflacionit të shënjestruar në përgjithësi, duke qenë se



ajo përfshin edhe ndryshimet nga përvojat e vendeve të tjera me adoptimin e inflacionit të shënjestruar.

STRUKTURA E RE E POLITIKËS MONETARE DHE REDUKTIMI I INFLACIONIT NË SERBI.

MILAN SOJIĆ, Drejtor i Sektorit të Analizave Ekonomike, Banka Kombëtare e Serbisë, prezantuar nga DAVID VÁVRA, Këshilltar, Banka Kombëtare e Serbisë

Me synimin për të garantuar kushtet makroekonomike kryesore për anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian, Banka Kombëtare e Serbisë ka adoptuar një kuadër të ri monetar, i cili parashikon ulje të mëtejshme të inflacionit bazë dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar. Për të arritur objektivat e saj, Banka Kombëtare e Serbisë përdor normën bazë të inflacionit, me fjalë të tjera normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dyjavore të zbatueshme në operacionet e tregut të hapur, si instrumentin e saj kryesor dhe zbaton një politikë të kursit të këmbimit të luhatshme.

STRATEGJIA E POLITIKËS MONETARE TË BANKËS KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË: PËRVOJAT DHE ALTERNATIVAT.

ANETA KRSTEVSKA, Drejtore e Departamentit të Kërkimeve, Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë

Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë ka ndjekur një regjim të shënjestrimit të kursit të këmbimit prej më shumë se një dekade, dhe deri tani ky regjim ka rezultuar të jetë shumë i suksesshëm. Qëllimi i këtij materiali është të shpjegojë shkurtimisht përparësitë e kësaj strategjie dhe të përqendrohet më shumë në analizën për qëndrueshmërinë e kursit të këmbimit fiks. Gjithashtu, materiali trajton efektivitetin e kanalit të transmetimit të ndryshimit të normës së interesit në ekonominë maqedonase.



POLITIKA MONETARE: KUADRI INSTITUCIONAL DHE OPERACIONAL DREJT NJË REGJIMI LARGPAMËS.
GRAMOZ KOLASI, BLENDAR HODA, SOFIKA NOTE,
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë

Politika monetare në Bankën e Shqipërisë ka evoluar drejt një përqsasjeje në linjë me strukturat bashkëkohore, që plotësojnë elementet që promovojnë eficiencën dhe efikasitetin. Ky material është një përpjekje për të ravigëzuar aspektet e reja dhe përmirësimet e atyre të mëparshme. Me këtë studim, autorët bëjnë një prezantim të plotë të detyrave të realizuara, të propozuara dhe të përpunuara kryesisht gjatë forumeve dhe konferencave të mëparshme, si dhe japin një vlerësim të përgjithshëm të kushteve të nevojshme për adoptimin e plotë të regjimit të inflacionit të shënjestruar në Shqipëri.

KOMENTE MBI: POLITIKA MONETARE: KUADRI INSTITUCIONAL DHE OPERACIONAL DREJT NJË REGJIMI LARGPAMËS.
MEIR SOKOLER, Këshilltar i politikës monetare në Bankën e Shqipërisë

Shqipëria është një ekonomi e vogël evropiane, e cila përfundimisht duhet të jetë pjesë e Bashkimit Evropian. Si e tillë, ajo duhet të përshtatë vazhdimisht institucionet dhe politikat e saja për të qenë në përputhje me rolin integruar. Në komentet e tij për punimin e Kolasi et al., z. Sokoler e cilëson atë një material informues për kuadrin e politikës monetare në Shqipëri. Duke qenë një version paraprak, z. Sokoler shpreh bindjen e tij se, në vijim materiali do të përmirësohet duke i kushtuar më tepër vëmendje ndryshimeve kritike të evidentuara nga autorët, të nevojshme për një adoptim të plotë dhe efikas të regjimit të inflacionit të shënjestruar në Shqipëri.



MODELI MAKROEKONOMIK I SHQIPËRISË: VAZHDIMI.
VASILIKA KOTA, ELONA DUSHKU, specialiste, Departamenti
i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë
JAKAB ZOLTAN, kryeekonomist, Banka Qendrore e Hungarisë

Me përgatitjen e Bankës së Shqipërisë për të adoptuar regjimin e inflacionit të shënjestruar në të ardhmen e afërt, nevojiten të dhëna të shumta mbi treguesit ekonomikë aktualë dhe vlerësime për të ardhmen. Autorët, me këtë material riparaqesin modelin makroekonomik të Shqipërisë (MEAM) dhe prezantojnë progresin e bërë për përmirësimin e tij gjatë vitit 2007. Modeli jep jo vetëm një panoramë të përgjithshme të lidhjeve dhe kanaleve kryesore të ekonomisë, por parashikon impaktin e shock-eve të ndryshme nëpër të cilat mund të kalojë ekonomia dhe zhvillimet e mundshme, si rezultat i adoptimit të një politike të caktuar.

KOMENTE MBI: MODELI MAKROEKONOMIK I
SHQIPËRISË: VAZHDIMI.
DAVID VÁVRA*, Këshilltar, Banka Kombëtare e Serbisë

ROLI I KURSIT TË KËMBIMIT NË KUADRIN E INFLACIONIT
TË SHËNJESTRUAR. ÇFARË BËJMË NE?
ALTIN TANKU, MARIAN GJERMENI, ILIR VIKA, Banka e
Shqipërisë

Ky dokument analizon marrëdhënien ndërmjet kursit të këmbimit dhe inflacionit në Shqipëri. Qëllimi i parë i autorëve të këtij materiali është të shqyrtojnë impaktin e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi çmimet e konsumit vendas dhe së dyti, të hedhin dritë mbi rëndësinë e lëvizjeve valutore në drejtimin e politikës monetare. Gjetjet mund të jenë të dobishme për politikëbërësit e bankës qendrore para adoptimit të plotë të regjimit të inflacionit të shënjestruar.



KOMENTE MBI: ROJË I KURSIT TË KËMBIMIT NË KUADRIN E INFLACIONIT TË SHËNJESTRUAR. ÇFARË BËJMË NE?
DAVID VAVRA*, Këshilltar, Banka Kombëtare e Serbisë
MEKANIZMI I TRANSMETIMIT NË SHQIPËRI.
GRAMOZ KOLASI, DIANA SHTYLLA, HILDA SHIJAKU,
Banka e Shqipërisë

Studimi ritrajton mekanizmin e transmetimit monetar në Shqipëri, duke bërë një përmbledhje të gjetjeve të studimeve të mëparshme dhe duke dhënë dëshmi të reja bazuar në një vlerësim SVAR. Autorët shqyrtojnë efektin e kanaleve të transmetimit monetar mbi prodhimin e përgjithshëm dhe mbi inflacionin total dhe atë bazë. Ata arrijnë në përfundimin se kanali i kursit të këmbimit nuk është aq i fortë sa është paraqitur në punimet e mëparshme dhe se kanali monetar dhe i pritshmërive luan rolin kryesor në mekanizmin e transmetimit.

KOMENTE MBI: MEKANIZMI I TRANSMETIMIT NË SHQIPËRI.
KERSTIN MITLID, Këshilltar e Governorëve, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka Qendrore e Suedisë.

Materiali i Kolasi et al. bën një përmbledhje të mirë të hulumtimeve të mëparshme mbi mekanizmin e transmetimit në Shqipëri. Rezultatet e reja që autorët morën nga modeli i tyre VAR janë interesante. Megjithatë, materiali ka vend për përmirësime pasi, sipas zj. Mitlid, në të nuk është plotësisht e qartë se cili është objektivi i ndërmjetëm që përdor Banka e

**Në momentin e përgatitjes së Katalogut të Publikimeve për vitin 2007, prezantimet e këtyre referuesve nuk kanë qenë në dispozicion për të përgatitur paragrafin përmbledhës. Ato do t'i gjeni në botimet e tjera të Bankës së Shqipërisë.*



Shqipërisë, cili është kuadri monetar i adoptuar dhe se cila pjesë e mekanizmit të transmetimit po testohet.

PUBLIKIME PERIODIKE

RAPORTI VJETOR

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë përmban një analizë të gjendjes ekonomiko-financiare të vendit si dhe veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë një viti. Ai gjithashtu, bën një përshkrim të zhvillimeve në ekonominë botërore dhe impaktin e saj mbi ekonominë vendase; të zhvillimeve në tregjet monetare, mbikëqyrjen bankare si dhe të veprimtarive të tjera të Bankës së Shqipërisë; pasqyrat dhe llogaritë financiare, të shoqëruara nga opinionioni i kontrollorëve, lidhur me gjendjen financiare të Bankës së Shqipërisë.

RAPORTET E POLITIKËS MONETARE

Vendimmarrja politike e Bankës së Shqipërisë është një e drejtë ekskluzive e Këshillit Mbikëqyrës së saj. Ky proces vendimmarrjeje bazohet në analizat dhe në parashikimet që çdo muaj të vitit janë pjesë e njërit prej raporteve të mëposhtme të politikës monetare:

- 1. Raporti Tremujor i Politikës Monetare, i cili përshkruan zhvillimet monetare për tremujorin e parë dhe për nëntëmujorin. Një vend të rëndësishëm përbën qëndrimi që duhet mbajtur në të ardhmen.*
- 2. Raporti Gjashtëmujor i Politikës Monetare. Ky raport analizon dhe vlerëson zhvillimet ekonomike e financiare të ekonomisë shqiptare gjatë gjashtë muajve të parë ose të fundit të një viti të caktuar.*



Në varësi të këtyre zhvillimeve, të ndikimit të tyre në inflacionin e periudhës së shqyrtuar dhe të pritjeve për të ardhmen jepet dhe qëndrimi i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

3. Dokumenti i Politikës Monetare. Është një përmbledhje e thjeshtuar e politikës monetare, që Banka e Shqipërisë do të ndjekë.

RAPORTI STATISTIKOR

Raporti Statistikor është botim i përmuajshëm që përgatitet nga Departamenti i Statistikës dhe përmban të dhëna për sektorin real, sektorin financiar, sektorin fiskal dhe sektorin e jashtëm.

BULETINI ZYRTAR

Buletini zyrtar është botim që përgatitet jo më pak se një herë në muaj dhe përmban të gjitha vendimet e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë me përjashtim të atyre që kanë karakter sekret ose konfidencial, rregullore, deklarata, opinione, rekomandime si dhe çdo akt tjetër me karakter të përgjithshëm, që gjykohen të përshtatshme për t'u botuar.

RAPORTI VJETOR I MBIKËQYRJES

Raporti Vjetor i Mbikëqyrjes përgatitet nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe përmban: një analizë vjetore të veprimtarisë së sistemit bankar dhe të mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë; një kuadër të plotë të ndryshimeve rregullatore mbikëqyrëse në përshtatje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare; statistika dhe



informacione mbi subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë si dhe çështje të ecursisë së sistemit bankar.

BULETINI VJETOR I BILANCIT TË PAGESAVE

Buletini Vjetor i Bilancit të Pagesave analizon hollësisht zhvillimet e sektorit të jashtëm të ekonomisë shqiptare, për vitin përkatës. Në këtë botim, bëhet një analizë e bilancit të pagesave sipas zërave të veçantë të llogarisë korente dhe llogarisë kapitale dhe financiare. Ai përmban analiza të detajuara të zhvillimeve në tregtinë e jashtme sipas grupmallrave dhe shteteve, analiza të ecursisë së shërbimeve, të të ardhurave, të transfertave korente dhe transaksioneve në llogarinë kapitale dhe financiare. Nëpërmjet një përshkrimi sintetik, ofron për përdoruesit e pasqyrës së bilancit të pagesave njohje me konceptin “bilanc pagesash”, duke prezantuar njëkohësisht burimet dhe metodologjinë e përdorur në hartimin e Bilancit Shqiptar të Pagesave. Buletini përmban, gjithashtu, një aneks statistikor ku do të gjeni seri kohore të dhënash për zërat kryesorë të bilancit të pagesave.

ARTIKUJ TË PUNONJËSVE TË BANKËS SË SHQIPËRISË, TË PUBLIKUAR NË SHTYPIN VENDAS

PSE HESHTIN EKONOMISTËT SHQIPTARË
ADRIAN CIVICI, gazeta “Shqip”, 5 shkurt 2007

EKONOMISTËT DHE EKOLOGJISTËT, MARRËDHËNIE TË
KOMPLIKUARA
ADRIAN CIVICI, gazeta “Shqip”, 13 shkurt 2007

EDUKIMI PËRBALLË SFIDËS SË ZHVILLIMIT EKONOMIK
ADRIAN CIVICI, gazeta “Shqip”, 17 shkurt 2007



POLITIKA EKONOMIKE APO RIGORIZITET BUXHETOR
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 17 shkurt 2007

PËR NJË SISTEM BANKAR TË ZHVILLUAR
ARDIAN FULLANI

Botuar në gazetën "Ekonomia", 7 mars 2007

Botuar në gazetën "Korrieri", 7 mars 2007

Botuar në gazetën "Rilindja Demokratike", 7 mars 2007

Botuar në gazetën "Panorama", 7 mars 2007

KAPITALIZMI ME "FYTYRË" HUMANE

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 21 mars 2007

"DETYRIMET" SOCIALE TË POLITIKAVE

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 1 prill 2007

KAPITALI DHE EKUILIBRI SOCIAL

ADRIAN CIVICI, GAZETA "SHQIP", 15 PRILL 2007

INTERVISTË E Z. ARDIAN FULLANI DHËNË ZËRIT TË
AMERIKËS

Botuar në gazetën "Albania", 20 prill 2007

Botuar në gazetën "Republika", 20 prill 2007

TENDENCAT E REJA NË SKENËN POLITIKE EVROPIANE

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 22 prill 2007

TË ZGJIDHET SA MË PARË PROBLEMI I ENERGJISË

ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 26 prill 2007

SFIDAT E UNIVERSITETEVE DHE TË KËRKIMIT SHKENCOR

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 28 prill 2007

ÇFARË PO NDODH ME EURON?

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 3 maj 2007

RRITJA E KREDIVE, NJË EKSPANSION QË DUHET

MONITORUAR

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 4 maj 2007

STABILITETI FINANCIAR I SHQIPËRISË

ARDIAN FULLANI, gazeta "Standard", 4 maj 2007



KËRCËNOHEMI ME RITJE TË ÇMIMEVE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 9 maj 2007

EKONOMIA E DIJES DHE SHOQËRIA E INFORMACIONIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 13 maj 2007

DEMOKRACIA DHE FILOZOFIA MODERNE E ZHVILLIMIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 3 qershor 2007

PËRBALLË PRESIONEVE INFLACIONISTE DHE ZGJERIMIT TË
DEFICITIT TREGTAR
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 21 korrik 2007

LUFTA PËR UJIN, NJËSOJ SI LUFTA PËR NAFTËN
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 7 gusht 2007

PIKËPYETJET E TEORIVE DHE MODELEVE TË ZHVILLIMIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 16 gusht 2007

TRANSPARENCA, ÇËSHTJE E RËNDËSISHME E POLITIKËS
MONETARE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 23 gusht 2007

BANKAT, MË TRANSPARENTE NDAJ KLIENTËVE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Zëri i Popullit", 23 gusht 2007

SINDROMA E VENDIT TË VOGËL
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 23 gusht 2007

ZJARRET NË PYJE: EMERGJENCA APO POLITIKA
PARANDALUESE?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 26 gusht 2007

DRITËHIJET E KAPITALIZMIT "MADE IN CHINA"
NGA ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 2 shtator 2007

GJENDJA E SISTEMIT BANKAR DHE SFIDAT NË TË
ARDHMEN
FATOS IBRAHIMI, gazeta "Ekonomia", 16 shtator 2007

ÇFARË PO NDODH ME ÇMIMIN E GRURIT DHE BUKËS?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 16 shtator 2007



PËRSE KA RËNDËSI BASHKËPUNIMI RAJONAL
ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 18 shtator 2007

INFLACIONI KAPËRCEN KUFIRIN, NE E PARALAJMËRUAM
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 25 shtator 2007

PRESIONET INFLACIONISTE NË RRIJJE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Zëri i Popullit", 25 shtator 2007

NEGOCIATAT ME ANGLINË NË '85 PËR ARIN E GRABITUR
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 1 tetor 2007

ÇFARË KUSHTESH VURI ENVERI PËR KTHIMIN E ARIT TË
GRABITUR
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 2 tetor 2007

KUSHTI I ANGLEZËVE NË 1985: NA KTHENI
DËMSPËRBLIMET E INCIDENTIT TË KORFUZIT
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 3 tetor 2007

PSE RAMIZ ALIA URDHËROI KTHIMIN URGJENT TË
DELEGACIONIT SHQIPTAR NGA PARISI
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 4 tetor 2007

BISEDIMET SHQIPTARO-BRITANIKE TË PARISIT, U MBYLLËN
PA REZULTAT
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 5 tetor 2007

PRESIONET INFLACIONISTE, NË RRIJJE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Zëri i Popullit", 9 tetor 2007

ÇMIMI "NOBEL" KURORËZON SHQETËSIMET PËR
NGROHJEN GLOBALE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 14 tetor 2007

UNIVERSITETET E SHEKULLIT XXI, SFIDAT E MODERNIZMIT
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 21 tetor 2007

KONTROLL E AKREDITIM ME NJË STANDARD PËR TË
GJITHA UNIVERSITETET
ADRIAN CIVICI, gazeta "Tema", 24 tetor 2007



INTERVISTË E Z. ARDIAN FULLANI DHËNË ZËRIT TË AMERIKËS

Botuar në gazetën "Republika", 25 tetor 2007
Botuar në gazetën "Ekonomia", 25 tetor 2007
Botuar në gazetën "Koha Jonë", 25 tetor 2007
Botuar në gazetën "Zëri i Popullit", 25 tetor 2007
Botuar në gazetën "Telegraf", 26 tetor 2007
Botuar në gazetën "Rilindja Demokratike", 26 tetor 2007

TREGU NDËRBANKAR NUK ZHVILLOHET SI TREG I IZOLUAR

ARDIAN FULLANI

Botuar në gazetën "Ekonomia", 27 tetor 2007
Botuar në gazetën "Zëri i Popullit", 27 tetor 2007

TREGJET BOTËRORE DHE ÇMIMET SHQIPTARE

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 28 tetor 2007

FILLON NJË ERË E RE NË ADMINISTRIMIN E REZERVËS VALUTORE

ARDIAN FULLANI,

Botuar në gazetën "Republika", 30 tetor 2007
Botuar në gazetën "Ekonomia", 30 tetor 2007

EKONOMIA, TË VAZHDOJË PROCESIN E LIBERALIZIMIT

ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 1 nëntor 2007

EURO, DOLLARI, NAFTA. Ç'NDODH NË TREGJET NDËRKOMBËTARE?

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 4 nëntor 2007

BUXHETI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK E SOCIAL

ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 11 nëntor 2007

RRITJA E KREDISË ENDE E LARTË, BURIM POTENCIAL RREZIKU PËR STABILITETIN MAKRO

ARDIAN FULLANI, gazeta "Zëri i Popullit", 15 nëntor 2007

ENERGJIA ALTERNATIVE RRIET KOSTON DHE ÇMIMIN E MALLRAVE NË TREG

ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 15 nëntor 2007



RRITJA E KREDISË, NJË POTENCIAL RREZIKU PËR
STABILITETIN MAKROEKONOMIK
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 15 nëntor 2007

EDHE NJË HERË PËR UNIVERSITETET
KSENOFON KRISAFI, gazeta "Panorama", 17 nëntor 2007

PRIVATIZIMI I SHËRBIMEVE PUBLIKE, STRATEGJI APO
EMERGJENCË?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 18 nëntor 2007

Ç'TË BËJMË ME ZHVILLIMIN E ZONAVE MALORE?
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 25 nëntor 2007

INFLACIONI DHE SHTRENJTIMI I LEKUT, ARSYET DHE
EFEKTET
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 2 dhjetor 2007

KREDITË NË VALUTË KËRCËNOJNË, NË RAST TË
ZHVLERËSIMIT TË LEKUT
ARDIAN FULLANI, gazeta "Republika", 7 dhjetor 2007

BORXHI PUBLIK I EMETUAR NË LEKË, I TREGTUESHËM NË
TREGJET NDËRKOMBËTARE
ARDIAN FULLANI, gazeta "Ekonomia", 7 dhjetor 2007

PASOJAT E MENTALITETIT E QEVERISJEVE "SOT PËR
NESËR"
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 9 dhjetor 2007

PËRBALLË KONCEPTIT "KAPITAL"
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 16 dhjetor 2007

RAPORTET ME INFLACIONIN NË STRATEGJITË E BANKAVE
QENDRORE
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 23 dhjetor 2007

DILEMAT E PROJEKTEVE POLITIKE (SHTET SOCIAL APO
EFEKTIVITET EKONOMIK)
ADRIAN CIVICI, gazeta "Shqip", 30 dhjetor 2007

*Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike
në adresën:*

www.bankofalbania.org

*Gjithashtu në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Sheshi "Skënderbej" Nr.1 Tiranë Shqipëri,
Tel.: +355-(0)4-222152;
Faks: +355-(0)4-223558*

*ose duke dërguar një e-mail në adresën:
public@bankofalbania.org*

Tirazhi: 1000 kopje

